

SKEMA E KOMPOSTIMIT ORGANIK NË KOMUNITETET RURALE



PËRSE TË KOMPOSTOJMË?



- Kompostimi kursen para - duke përdorur kompostimin organik zvogëlohet përdorimi i plehrave kimike dhe rritet cilësia e tokës. Gjithashtu ju do ta krijoni vetë kompostin (humusin).
- Bimë të shëndosha - Bimët plotësohen me lëndë organike që i bën më të shëndetshme dhe më rezistente ndaj sëmundjeve të ndryshme.
- Mbrohet mjedisi - zvogëlohet ndotja e tokës

Kompostimi mund të bëhet gjatë gjithë vitit. Gjatë procesit të kompostimit rritet temperatura në materialin që kompostohet, pra nxehtësia lëshohet për shkak të punës së mikroorganizmave në mënyrë që temperatura e ulët jashtë të mos ndalojë procesin e kompostimit në vete, por vetëm ta ngadalësojë atë.

Kompostimi duhet të vijojë dhe në periudhën dimërore duke patur parasysh:

- Të përzihet masa në komposter (para nisjes së dimrit)
- Në temperatura të ulëta dekompozimi vazhdon më ngadalë se në temperatura të larta



KOHA PËR KOMPOSTIM!

ÇFARË MUND TË KOMPOSTOHET?

»»» MBETJET E GJELBËRTA-TË FRESKËTA DHE KAFE-TË THATA

- Mbetjet e gjelbra: mbetje të pasura me azot - mbetje të frutave, perimeve dhe lëvoret e tyre, mbetjet e kafesë dhe çajit, bari i prerë. Lënda e gjelbër siguron azot, lagështi dhe ushqim për mikroorganizmat e gjallë që e shndërrojnë lëndën organike në kompost
- Mbetjet kafe: mbetje të pasura me karbon - gjethe dhe degë të thata, kashtë, sanë, mbetje nga frutat e thara, mbetjet e krasitjes, tallash. mbetje letrash dhe kartona vezësh.

KOMPOSTI KUR I
HIDHET TOKËS
PËRMIRËSON
CILËSINË E SAJ DUKE
LEHTËSUAR
PROCESIN BIOLOGJIK
TË TOKËS. AI
PËRDORET SI
SUBSTRAKT NË
PRODHIMET E
NDRYSHME BIMORE,
SI ELEMENT
VITAMINOZ I
AJROSJES SË TOKËS
OSE SI PLEH.

»»» DISA KËSHILLA PRAKTIKE

- Respektoni llojin e mbetjeve që hidhni në komposter
- Copëtojini mbetjet e biodegradueshme që hidhni në komposter dhe ruani raportin e llojit të mbetjeve (të gjelbra dhe kafe)
- Shtimi i materialit të gjelbërt dhe mbulimi i grumbullit do të shpejtojë dekompozimin.
- Nëse grumbulli është i thatë duhet të laget
- Nëse grumbulli i kompostit ka erë të pakëndshme materiali është shumë i lagësht. Në këtë rast shtohet material kafe (degë të thata) dhe masa duhet të përzihet mirë.

